

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

“Green Partner Albania” shpk

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJGJËSI TË KUFIZUAR “ GREEN PARTNER ALBANIA”

Datë:17/10/2022

KREU I

EMRI I SHOQËRISË , SELIA , KOHËZGJATJA,OBJEKTI

Neni 1

EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri I shoqërisë me përgjgjësi të kufizuar është “ **GREEN PARTNER ALBANIA**” SHPK (më poshtë quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : “**Durres,Rrashbull,Vrrine, Zona kadastrale 3339,Nr.Pasurie 288**”

- 2.2 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3



KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj nga themelimi sot datë **17.10.2022** për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

Neni 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë , duke u fokusuar kryesisht në :

- 1) Shërbime ligjore në fushën e Mjedisit, Shëndetit dhe Energjisë ;
- 2) Asistencë për Leje Mjedisore, Autorizime dhe Licensime nga organet publike;
- 3) Vlerësime mjedisore;
- 4) Hartimi i raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe VSNM , Raporte Periodike Monitorimi i kushteve të Lejeve Mjedisore
- 5) Grumbullim, Transportim, Ruajtje, Riperdorim , Diferencim, Riciklim , Asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
- 6) Tërheqja e mbetjeve të lëngta dhe të ngurta të rrezikshme dhe jo të rrezikshme nga subjekte të ndryshme;
- 7) Pastimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme në zona qytetase , rurale , portuale , aeroportuale , subjekte publike dhe private;
- 8) Hartimi i planeve të emergjencave për reagimin ndaj ndotjeve për Portet në Republikën e Shqipërisë
- 9) Menaxhim Energjie për Konsumatorë të ndryshëm Energjie
- 10) Auditime Energjie në Banesa dhe Industri;
- 11) Shitje e pajisjeve laboratorike;
- 12) Mirembajtje e pajisjeve laboratorike stacioneve monitoruese dhe cdo pajisje tjetër me funksione matëse;
- 13) Mirembajtje, kalibrim i pajisjeve laboratorike stacioneve monitoruese dhe cdo pajisje tjetër me funksione matëse;
- 14) Konsulencë për Akreditimin e Laboratorëve sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 15) Kryerje e analizave Laboratorike në fushën e Mjedisit për parametra të matshëm në Ujë , Ajër , Tokë;
- 16) Shërbime të Dezinfektimit , Deratizimit dhe Dezinfektimit (DDD) për mjedisë të ndryshme;
- 17) Menaxhimi i burimeve të energjisë , duke lidhur marrveshje bashkpunimi me subjekte private apo shtetërore , me qëllim uljen e konsumit të energjisë;
- 18) Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të cdo lloji;
- 19) Import-Eksport i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
- 20) Pastimi detar në zona portuale , reagim ndaj ndotjeve hidrokarbure dhe të tjera; 21) Shitje-Blerje e metaleve të ndryshme dhe skrapeve të metaleve;
- 22) Prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet projektimit , operimit dhe transferimit të burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, të tilla si sistemet fotovoltaike, gjeneruesit me erë, burimet gjenerues të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë si dhe gjeneruesit me biomasë;

- 23) Shitja e Paneleve Fotovoltaike për banesa dhe për industri;
- 24) Shitje e pajisjeve të ndryshme elektronike si Kompjuter (PC) , Lap-Top , Ekrane ,Hard disk,Kamera , printera , fotokopje , skaner, pajisje audio etj , Shitje e sofërëve të ndryshëm , Ngritja ,mbikqyrja , asistimi i sistemeve, programeve të ndryshme softëare në fushën e sigurisë, monitorimit , aksesimit etj;
- 25) Studim, Projektim dhe Mbikqyrje e zbatimit të punimeve në ndërtim, ndërtime civile;
- 26)Shitje e materialeve kancelarie për zyra;
- 27) Shitje e materialeve të ndryshme të pastrimit;
- 28) Shërbime në sheshe kontenieresh në terminale portuale për zhvendosjen e tyre, hapjen , zbrazjen dhe mbushjen e tyre me mallrat e ndryshëm;
- 29)Shitje materiale kundër zjarrit , pajisje zjarrifkese , veshje kundër zjarrit etj;
- 30)Shit-Blerje dhe dhenien me qira të automjeteve;
- 31) Shërbime ekspertize në fushën e pyjeve dhe kullotave, hartimi i planeve të menaxhimit, inventarizim, shërbime plotësuese dhe aktivitete të tjera që lidhen me pyjet ;
- 32) Shitje e materialeve elektrike dhe ndricuesve
- 33) Projektim, Mbikqyrje , Koalidim , Zbatim i veprave infrastrukturore tokësore , detare
- 34) Projektim i Impjanteve të ujërave të ndotura urbane dhe industrial
- 35) Asistencë në aplikimin e projekteve për marrjen e fondeve nga donator vendas e të huaj në fushën e bujqësisë , blektorisë dhe të tjera lidhur me to.
- 36) Shërbime në veprimtaritë për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to , Autoriparimi i pjesëve me motor dhe rimorkiove
- 37) Tregtimi i mineraleve të ndryshme
- 38) Shërbime logjistike transporti mallrash në hapësira portuale
- 39) Cdo aktivitet tjetër tregtar në zbatim të legjisllacionit shqiptar në fuqi.

4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria :

- a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja , që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose subjekteve pjesëmarrësë;
- b) Mund të lidhë kontrata bashkpunimi me shoqëri të tjera , individë , profesionistë të lirë Brenda dhe jashtë territorit Shqiptar;
- c) Mund të lidhë kontrata shitblerje , përdorimi , qeraje , shkëmbimi , sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë , bashkë investitorë , operatorë dhe administrues të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme
- d) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë po pa u kufizuar në : ofrimin e garancive reale dhe /ose personale për detyrimet veta dhe të tjetërve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave/dhe ose burimeve njerëzore nëpërmjet

shoqërive ose sipërrmarjeve në të cilat, direct apo indirect , Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre .

Kreu II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Neni 5

KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 10.000 (Dhjetë mijë) i ndarë në 1 (një) kuaotë. Kapitali I Shoqërisë nënshkruhet menjëherë nga ortakët i vetëm që zotëron 100% (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë , specifikisht:

- Znj. Silvana Luka, shtetase shqiptare , e lindur në Luz, më 21/09/1975, identifikuar me Kartën e Identitetit me nr.034521220 dhe numër personal H55921108C e cila zotëron 100% (njëqind për qind) të kapitalit.

5.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

6.1 Në rast se një ortak apo bashkëzotëues I një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmet persona që do t'i njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria, por asnjë nga këto parashikime nuk cliron përgjigjësitë e trashëgimtarëve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëues I kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëues I kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëuesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në cdo mbledhje të Asamblesë



së Përgjithshme , deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregëtar si zotërues I kuotës.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve që janë thirrur po nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortake heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënskruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortake mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.
- 7.4 Në rastin e një ortaku të vetëm , Administratori vepron si organ kolegjal për marrjen e të gjitha vendimeve që do të merreshin nga Asambleja e Përgjithshme nëse do ekzistonte një e tillë.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogelohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KREU III ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 9 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarres i Shoqërisë , në rast se ajo nuk ekziston Administratori vepron si organ kolegjal. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marreveshje midis ortakeve të Shoqërisë.
- 9.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai



- zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 9.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 9.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te mbahet brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese së Pergjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencen (conference call) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Pergjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkates.
- 9.6 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Pergjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve në adresat e njoftuara Shoqerisë, të pakten 5 (pese) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 9.7 Asambleja e Pergjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 9.8 Mbledhjet e Asamblesë së Pergjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Pergjithshme cakton një sekretar për cdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.9 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.11 Asambleja e Pergjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12.
- Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Pergjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 3 (tri) ditëve nga mbledhja e parë.
- 9.12 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesemarres apo të përfaqësuar që zoterojne me shume se 50% te kapitalit te Shoqerise për ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU I V

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një apo me shume Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në cdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë .
- 10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 10.4 Administratori do të veprojë në cdo kohe vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga cdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.5 Administratori i vetëm i Shoqërisë do të jetë:
- **Znj. Silvana Luka shtetase Shqipëtare , e lindur në Luz, më 21/09/1975, identifikuar me Kartën e Identitetit me nr.034521220 dhe numër personal H55921108C e cila zotëron gjithashtu dhe 100% (njëqind për qind) të kapitalit.**

NENI 11

PERFUNDIMI I DETYRES SE

ADMINISTRATORIT

- 11.1 Detyra e Administratorit perfundon në rast se:
- (a) i perfundon mandati;
 - (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
 - (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
 - (d) personi nuk gëzon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
 - (e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.



KREUV
KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR,
BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 12

KONTROLLI FINANCIAR

12.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13

VITI FINANCIAR

13.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

NENI 14 BILANCI VJETOR

14.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogarite vjetore.

14.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 15

DIVIDEDI

15.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asambles



Përgjithshme, mund të vendose shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

- 15.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendet duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendet do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë cdo pjesë ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

KREU VI

PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 16

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 16.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 17

LIGJI I ZBATUESHEM

- 17.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislatimit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 18

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 18.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet paleve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (tre) kopje në gjuhë shqipe.



Ortakja e vetme dhe Administratore

SILVANA LUKA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'SL', is centered below the name 'SILVANA LUKA'. The signature is stylized and cursive.

